

Numri i dosjeve	Titulli	Viti (Filluar-Mbaruar)	Sasia e fletëve
I	<b>Politiko - Juridike.</b>		
I-454	Vendime, lista e korrespondencë mbi ndarjen administrative të vendit si dhe krijimin, transferimin e syprimimin e qendrave të organeve lokale.	01.04.1922 - 08.08.1925	103
I-668	Shkresë e Kryeministrisë dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme ku kërkohet që të ndërhyhet pranë Lidhjes së Kombeve që Qeveria Amerikane të dëbojë nga Amerika komunistët shqiptarë.	06.05.1925	1
I-669	Njoftim i Komandës së Përgjithshme të Gjindarmërisë me të cilën informon Kryeministrinë mbi ardhjen e një personi nga Izmiri në Shqipëri dhe se ky person është komunist e do të bëjë propagandë mbi komunizmin.	07.22.1925	1
I-671	Lutje të antarëve të ish shoqërisë " Përlindja "Korçë drejtuar Kryetarit të Republikës me të cilën kërkojnë që të lejohet për rihapjen e shoqërisë në fjalë për vazhdim të veprimtarisë në mbrojtje e naltësimin e pozitës të gruas shqiptare.	11.24.1925 - 12.07.1925	2
I-672	Telegram i kryetarit të shoqërisë " Vatra " në Boston dërguar Presidentit të Republikës i cili i uron mbi zgjidhjen e çështjes së kufirit dhe për faljen e të arratisurve.	10.21.1925 - 10.26.1925	2
I-673	Korrespondencë ndërmjet Kryeministrisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme e tjera si dhe informata e njoftime mbi lëvizjet e të arratisurve politikë që ndodhen jashtë Shqipërisë si Riza Cerova, Sotir Peci e tjerë, hyrjet e daljet në Shqipëri si dhe përgatitjet që bëhen nga këta për një revolucion në Shqipëri kundër regjimit të Ahmet Zogut e tjera.	02.02.1925 - 11.05.1925	107
I-674	Njoftim të Ministrisë së Punëve të Brendshme dërguar Kryeministrisë me të cilën informon mbi situatën politike në Mirditë e Zerqan dhe masat që duhen të merren kundër ndonjë ngjarje apo lëvizje të rëndësishme.	05.01.1925 - 09.24.1925	8
I-675	Raport mujor i Ministrisë së Punëve të Brendshme paraqitur Kryeministrisë mbi situatën e përgjithshme të Shqipërisë si dhe nga ana politike, ekonomike e financiare.	09.01.1925	6
I-676	Njoftime të shkurtra të prefekturave me të cilat njoftojnë dhe situatën në qarkun e tyre.	08.02.1925 - 08.29.1925	62
I-677	Raport i Prefektit të Kosovës dërguar Ahmet Zogut mbi gjendjen politike të Qarkut e Prefekturës në Kosovë e shumë çështje e hollësira të tjera.	10.27.1925	8
I-678	Njoftime të Komandës së Operacionit në Korçë mbi situatën në këtë qark, masat që parashtrohen të merren, lajmet që janë përhapur mbi përgatitjen e një komploti e masat për zbulimin e tij.	02.04.1925 - 12.14.1925	10

<b>Numri i dosjeve</b>	<b>Titulli</b>	<b>Viti (Filluar-Mbaruar)</b>	<b>Sasia e fletëve</b>
I-680	Shkresa mbi dhënien e një subvencioni fletores jugosllave për lejimin e botimeve që mund të bëhen nga Legata Shqiptare mbi gjendjen politike, ekonomike të Shqipërisë etj.	08.08.1925	1
I-681	Kol Rodhe kërkon ti jepet leje për botimin e një gazete.	07.08.1925 - 07.14.1925	3
I-683	Projektligj mbi censurimin e gazetave dhe të letrave postare.	01.27.1925 - 03.25.1925	6
I-684	Vendim i Këshillit të Ministrave e korrespondenca përkatëse mbi mbylljen e fletoreve " Lirija " e " Tirana " si dhe korrespondencë mbi dënimin e redaktorit Jorgji Meksi për një botim që ka bërë në fletoren " Labëria " në dëm të regjimit.	05.11.1925 - 11.09.1925	24
I-685	Korrespondencë mbi dhënie leje për mbajtje arme si dhe ndalimi i sjelljes dhe tregtimit të armëve.	04.01.1925 - 08.20.1925	5
I-686	Korrespondencë mbi marrje masa ligjore kundër personeve që zbrazin pushkë.	08.06.1925 - 08.09.1925	2
I-687	Njoftime mbi rënie zjarri e djegie shtëpie si dhe masat që duhen marrë për zënien e dënimin e shkaktarëve.	01.15.1925 - 08.10.1925	8
I-688	Dekreligj mbi faljen e delikteve ordinere dhe të krimeve vetëm për çështje nderi si dhe korrespondenca kundër nënshtetasve shqiptarë që bëjnë vjedhje e vrasje jashtë kufirit.	03.21.1925 - 09.24.1925	12
I-689	Njoftime të Komandës së Gjindarmërisë ku njoftohet Kryeministria mbi ngjarjet 10 ditore si vrasje, plagosje, vjedhje etj.	08.15.1925 - 10.20.1925	50
I-690	Dekret, korrespondencë dhe kërkesa, lista etj, mbi burgime, arrestime, mbajtje nën vërejtje, dënime si dhe falje dhe lirime nga burgu.	01.09.1925 - 12.19.1925	250
I-691	Kërkesa dhe korrespondencë mbi ndërmjetësimin pranë Qeverisë Franceze mbi lirimimin e të burgosurve shqiptarë në Francë.	01.26.1925 - 07.15.1925	9
I-692	Dekretligj e korrespondencë përkatëse mbi disa ndryshime në ligjin mbi internimin e familjeve dhe konfiskimin e pasurive e të arratisurve.	02.18.1925 - 12.01.1925	27
I-693	Dekrete, urdhëra, lista e korrespondencë ndërmjet Kryeministrisë e Ministrisë së Punëve të Brendshme e Ministrisë së Drejtësisë mbi faljen e të arratisurve politikë.	01.19.1925 - 11.28.1925	60
I-694	Kërkesa të personave të ndryshëm e korrespondenca mbi marrjen e masave kundër personave vjedhës dhe grabitës të grave të tyre.	02.11.1925 - 12.30.1925	52
I-695	Ankesa të popullit të disa katundeve e personave të ndryshëm mbi sjelljet, rrahjet, vjedhjet e tjera që ju bëhen nga autoritetet e policisë, xhandarmërisë, oficerë e dedashmentet e ndryshme si dhe korrespondencë mbi masat që duhen marrë.	01.17.1925 - 12.21.1925	50

Numri i dosjeve	Titulli	Viti (Filluar-Mbaruar)	Sasia e fletëve
I-696	Njoftime, raporte e korrespondencë mbi vjedhjet që vrasjet që bëhen në zona të ndryshme të vendit nga çeta hajdute e masat që merren kundër tyre si dhe dokumente mbi çetën e Mero Lamçes dhe kapja e vrasja e tij.	01.15.1925 - 12.22.1925	35
I-697	Lista të kusarëve që kanë hyrë në tokën shqiptare, ata që janë zënë e dënimet që u janë dhënë.	1925	2
I-698	Njoftime mbi prerjen e lidhjeve telefonike, thyerjen e shtyllave, masat që duhen marrë si dhe ankesa të popullsisë të katundeve Kolonjë e Leskovik për mospagimin e gjobave që u janë vënë nga qeveria për prerjen e lidhjeve telefonike në këtë zonë.	06.12.1925 - 12.05.1925	13
I-699	Korrespondencë ndërmjet Kryeministrisë e Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë si dhe kërkesa të disa kryeplesësive dhe personave të ndryshëm, mbi vrasjet e grabitjet që ju bëhen nga persone me uniformën e Republikës e nga të tjerë, prandaj kërkojnë zënien e këtyre guximtarëve dhënien e dënimeve të drejta e pa anësi.	01.09.1925 - 10.22.1925	64
I-700	Korrespondencë ndërmjet Kryeministrisë e Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë mbi mosndjekjen e gjyqjeve kundër guximtarëve të vjedhjeve e borxheve të bëra para Kongresit të Lushnjës.	04.08.1925 - 04.15.1925	4
I-701	Kërkesë e Klubit Skënderbeg, Atlantility USA me të cilën kërkon amnisti për fajtorët politikë që gjenden jashtë si dhe një kërkesë e Faik Bregut për një amnisti për refugjatët.	03.14.1925 - 10.12.1925	4
I-702	Përmendore që paraqitet për aprovim mbi disa masa që duhen të merren që nëpunësit e shtetit të mos merren me politikë.	12.02.1925	12
I-703	Korrespondencë mbi ankesat që bën populli i krahinave të ndryshme për vjedhjet, grabitjet etj që u bëhen nga ushtarët, gjindarmët e fuqitë operative.	03.21.1925 - 11.25.1925	37
I-704	Urdhërohet që pa lejen e Komandës së Operacionit në Shkodër, Kosovë e Dibër të mos bëhet asnjë lloj mbledhje nga ana e autoriteteve për çfarëdo nevoje që të kënë.	10.01.1925	1
I-705	Vendime të Këshillit të Ministrave, vendime dhe propozime të prefekturave e korrespondenca me Ministrinë e Punëve të Brendshme mbi internime, nxjerrje jashtë kufirit të elementëve turbullues e propagandiste kundër regjimit në fuqi si dhe transferim dhe lirim nga internimi.	03.09.1924 - 04.29.1925	200
I-706	Ligj mbi ndëshkimin e fajëve politike.	11.30.1925 - 12.27.1925	20
I-708	Projektligj mbi internimin e propagandistëve të rrezikshëm.	02.26.1925 - 11.10.1925	4

<b>Numri i dosjeve</b>	<b>Titulli</b>	<b>Viti (Filluar-Mbaruar)</b>	<b>Sasia e fletëve</b>
I-709	Deklarata dhe korrespondenca përkatëse mbi lidhjen e besës së popullit të Dukagjinit.	01.08.1925 - 08.13.1925	23
I-711	Dekret, vendime e korrespondencë mbi faljen e të arratisurve politikë që kthehen në Shqipëri si dhe lutje të Riza Cerovës etj që kërkojnë të mos kthehen në afatin e caktuar.	09.07.1925 - 09.20.1925	27
I-712	Njoftime mbi sjelljet e milicisë ndaj autoriteteve qeveritare si dhe telegram i Seid Vrionit i cili thotë se është atakuar nga një person që bën pjesë në komplotin e formuar në Berat.	01.18.1925 - 02.07.1925	3
I-713	Korrespondencë mbi dhënien në gjyq të një nënshtetasi italian për sharje e ofeza kundër Qeverisë Shqiptare.	01.07.1925 - 07.08.1925	4
I-714	Raporte dhe informata mbi veprimet dhe propagandën e rrezikshme që bëjnë disa nëpunës kundër regjimit në fuqi si dhe masat që duhen marrë ndaj tyre.	05.07.1925 - 10.17.1925	32
I-716	Një letër i drejtohet Ahmet Zogut e Ceno Kryeziut ku jepen disa hollësira mbi gjendjen si dhe paniku e tmerrri që i është futur popullit të Sarandës nga shërbëtorët e Myfit Libohovës etj e kështu për në Vlorë, Durrës etj.	1925	2
I-717	Korrespondencë mbi një projektligj mbi ndalimin e pederastisë.	10.31.1925 - 11.04.1925	2
I-719	Korrespondencë ndërmjet Kryeministrit e Ministrit të Punëve të Jashtme mbi pëlqimin dhe aprovimin e konsujve të shteteve të huaja të emëruar në vendin tonë, paraqitja e letër patentave për ushtrimin e misionit etj.	02.22.1925 - 12.27.1925	34
I-720	Korrespondencë ndërmjet Kryeministrit e Ministrit të Punëve të Jashtme, Ministrit të Punëve të Brendshme e njoftime të Komandës së Gjindarmërisë mbi lëvizjet, sjelljet e ndërhyrjet që bën ministri grek në Shqipëri prandaj kërkohet ndërhyrja për largimin e tij nga Shqipëria e zëvendësimin me një tjetër.	07.04.1925 - 09.19.1925	5
I-721	Njoftime të Ministrit të Punëve të Jashtme mbi emërimin e Kryetarit të ri të Republikës Gjermane si dhe hymni kombëtar i Gjermanisë.	05.18.1925 - 12.08.1925	3
I-722	Vendim i Këshillit të Ministrave e korrespondenca me Ministrinë e Punëve të Jashtme mbi emërimin e delegatëve për të përfaqësuar Shtetin Shqiptar pranë Lidhjes së Kombeve në Gjenevë.	08.19.1925 - 08.30.1925	2
I-723	Raport politik mujor i Ministrit të Punëve të Jashtme dërguar Kryeministrit ku njoftohen çështje që janë biseduar në Selinë e Asamblesë së Lidhjes së Kombeve si dhe puna e bërë nga legatat tona e të tjera çështje.	10.11.1925	4

Numri i dosjeve	Titulli	Viti (Filluar-Mbaruar)	Sasia e fletëve
I-724	Projektligj, raport justifikues e korrespondenca përkatëse të Ministrisë së Punëve të Jashtme paraqitur Kryeministrisë mbi përdorimin e studentëve shqiptarë që studiojnë jashtë shtetit si Atashe Syrnumerar pranë legatave tona për tu stërvitur e përgatitur sa më mirë si dhe refuzimi i këtij projektligji, mbasi studentët kanë filluar të merren me politikë etj.	10.02.1925 - 11.21.1925	8
I-725	Informacion i Legatës Shqiptare në Beograd dërguar Ahmet Zogut mbi politikën që ndjek Jugosllavia për dhënien e bursave djemve shqiptarë, si dhe emrat e nxënësve që ndjekin shkollat në Jugosllavi.	12.14.1925	5
I-726	Letër e Konsullit Shqiptar në Bari dërguar Ahmet Zogut në të cilën shkruan hollësisht mbi bisedimet që janë bërë ndërmjet Musolinit e Ministrit të Jashtëm të Bullgarisë mbi Shqipërinë e personin tuaj etj.	06.01.1925	3
I-727	Njoftime të legatave shqiptare në shtete të ndryshme mbi gjendjen politike-ekonomike në Ballkan si dhe marrëdhëniet e shteteve midis tyre.	04.04.1925 - 12.18.1925	36
I-729	Njoftime të legatave shqiptare nga Beogradi, Roma etj, mbi refugjatët politikë shqiptarë në këto vende, lëvizjet e tyre etj si dhe atentati i bërë kundër Kol Mjedës nga emigrantët politik shqiptarë në Sarajevë.	04.11.1925 - 11.03.1925	21
I-730	Njoftime të Legatës Shqiptare në Beograd dërguar Kryeministrisë mbi marrëdhëniet Jugosllave me Shqipërinë, këmbim vizitash të personaliteteve qeveritare midis dy shteteve etj.	04.30.1925 - 08.06.1925	6
I-731	Nota verbale të Ministrisë së Punëve të Jashtme, dërguar Kryeministrisë, me të cilën dërgohet një intervistë dhënë nga i dërguari i jashtëzakonshëm i Rumanisë në Shqipëri, mbi gjendjen e Shqipërisë.	1925	3
I-732	Korrespondencë ndërmjet Kryeministrisë e Ministrisë së Punëve të Jashtme e njoftim i Legatës Shqiptare në Beograd mbi lajmet tendencioze në shtypin e huaj mbi Shqipërinë e turbullimet në Shqipëri si dhe përgënjeshttrimet e tyre nga ana e përfaqësuesve tanë.	05.26.1925 - 06.06.1925	6
I-733	Njoftime dhe informata të Komandës së Gjindarmërisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme etj, mbi propagandën e përgatitjet etj që bën Jugosllavia rreth kufirit tonë duke sjellë armë, ushtri etj si dhe njoftimet mbi vizitat e mbretit jugosllav e personaliteteve të tjera, takimet e tyre etj.	05.26.1925 - 11.07.1925	22
I-734	Njoftim i Legatës Shqiptare në Beograd mbi bisedimet që janë bërë me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Jugosllavisë mbi tharjen e liqenit të Shkodrës.	04.14.1925	1

<b>Numri i dosjeve</b>	<b>Titulli</b>	<b>Viti (Filluar-Mbaruar)</b>	<b>Sasia e fletëve</b>
I-735	Korrespondencë mbi prishjen e piramidave në kufirin greko-shqiptar dhe ndërhyrja pranë autoriteteve greke për ndreqjen e tyre.	03.08.1925 - 03.12.1925	2
I-736	Korrespondencë ndërmjet Kryeministrit e Komandës së Përgjithshme të Gjindarmërisë mbi lejimin e kufizoreve jugosllav të mbushin ujë brenda kufirit shqiptar.	07.06.1925	2
I-737	Korrespondencë me të cilën njoftohet mbi daljen në Sarandë të gjashtë priftërinjve grekë, gjoja për një marrëveshje për ndihmë të strehës vorfnore.	07.14.1925	2
I-738	Korrespondencë dhe njoftime ndërmjet Kryeministrit, Ministrit të Punëve të Brendshme e Komandës së Përgjithshme të Gjindarmërisë mbi ardhjen e tre personave nga Jugosllavia për hetime rreth çështjes së grabitjes së prefektit të Ohrit së bashku me dy të tjerë, mbasi mendohet se kjo grabitje është bërë nga shqiptarët, demarshet për moshyrjen e këtij komisioni për hetime brenda kufirit etj.	10.26.1925	6
I-739	Njoftim i Legatës Shqiptare në Athinë mbi bisedimet që ka bërë me autoritetet greke lidhur me respektimin e miqësisë shqiptaro-greke.	04.11.1925	1
I-740	Korrespondencë mbi hetimet rreth një letre drejtuar Legatës Italiane në Shkodër për sharje e fyerje kundër Italisë.	09.28.1925	3
I-741	Korrespondencë me të cilën njoftohet mbritja e dy anijeve luftime italiane në portet tona, pritja që ju bë si dhe njoftimi mbi një incident midis fuqive civile e avullores italiane.	08.03.1925 - 09.15.1925	11
I-742	Konventë lidhur ndërmjet Shqipërisë e Turqisë mbi çështje nënshtetësie.	02.24.1925 - 06.02.1925	14
I-743	Korrespondencë ndërmjet Kryeministrit, Ministrit të Punëve të Jashtme, Ministrit të Drejtësisë etj, mbi çështjen e shkëmbimit të kriminelëve ordiner të arratisur ndërmjet Shqipërisë, Italisë, Greqisë dhe Jugosllavisë.	05.19.1925 - 06.03.1925	8
I-744	Vendim e korrespondencë mbi çështjen e vrasjes së dy amerikanëve.	10.09.1924 - 04.18.1925	5
I-745	Korrespondencë ndërmjet Kryeministrit, Ministrit të Punëve të Brendshme etj, mbi 3-4 persona të ardhur nga Greqia në Sarandë të cilët janë autorët e një grabitje të një katundi të Nënprefekturës Filat Çamëri dhe Qeveria Greke po merr masa të rënda internime etj kundër familjeve shqiptare mbasi insistohet nga Qeveria Greke se grabitësit janë shqiptarë, pra kërkohet që këta ti dorëzohen Qeverisë Greke, urdhërohet nxjerrja e tyre jashtë kufirit.	06.18.1925 - 07.22.1925	4

<b>Numri i dosjeve</b>	<b>Titulli</b>	<b>Viti (Filluar-Mbaruar)</b>	<b>Sasia e fletëve</b>
I-746	Dekrete, vendime e korrespondenca përkatëse mbi suprimim ministri e drejtori të ndryshme etj si dhe krijime dhe aneksime, organizim e kompetencat përkatëse.	01.27.1925 - 12.22.1925	107
I-747	Ligj dhe dekretligje e korrespondenca përkatëse mbi formimin dhe organizimin e gjykatave.	01.15.1925 - 12.15.1925	114
I-748	Dekret, vendime e korrespondenca mbi shpërngulje, transferim suprimim e rikrijimin e qendrave të prefekturave e nënprefekturave e krahinave si dhe ankesa të popullit mbi këto suprimime.	01.08.1925 - 11.23.1925	137
I-749	Qarkore e Kryeministrisë mbi kompetencat e prefekturave dhe nënprefekturave.	10.27.1925 - 11.02.1925	2
I-750	Vendim i Këshillit të Ministrave mbi vënien e emrit një katundi që formohet i ri.	04.21.1925 - 05.04.1925	2
I-751	Korrespondencë mbi një mbledhje të përgjithshme që bëhet në Tiranë me parinë dhe krerët e gjithë viseve të veriut si dhe listat e personave pjesëmarrës.	06.09.1925 - 06.23.1925	8
I-752	Shpallje e zgjedhjes së Ahmet Zogut si Kryetar i Republikës si dhe proklamata.	01.07.1925	4
I-753	Dekrete, shtojca ligje, qarkore, korrespondencë e ankesa të ndryshme mbi zgjedhjet.	01.05.1925 - 12.13.1925	99
I-754	Qarkore të Kryeministrisë mbi kriteret në emërimet si dhe korrespondencë dhe kërkesa mbi emërimet, pushime, dhënie dorëheqje të ministrave, ngarkimi me zëvendësi etj në kuadrin e Kryeministrisë.	01.05.1925 - 12.21.1925	128
I-755	Dekrete, ligje, vendime e korrespondencë mbi emërimet, transferime, pushime etj të prefektëve, nënprefektëve, këshilltarë e quadro të tjera në vartësinë e Ministrisë së Punëve të Brendshme.	01.08.1925 - 05.20.1925	200
I-755/a	Dekrete, ligje, vendime e korrespondencë mbi emërimet, transferime, pushime etj të prefektëve, nënprefektëve, këshilltarë e quadro të tjera në vartësinë e Ministrisë së Punëve të Brendshme.	07.06.1925 - 12.27.1925	149
I-756	Korrespondencë e Ministrisë së Punëve të Jashtme me Kryeministrinë mbi emërimet, pushime etj të kuadrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme.	01.09.1925 - 12.01.1925	51
I-757	Korrespondenca mbi emërimet, transferime, pushime etj në kuadrin e Drejtësisë.	01.08.1925 - 06.22.1925	219
I-758	Dekrete, vendime, korrespondencë e kërkesa mbi gjendjen e emigrantëve shqiptarë jashtë vendit, ndihmat që ju kërkojnë për tu kthyer në Athinë si dhe instalimi i tyre etj.	01.28.1925 - 12.30.1925	176
I-810/1	Emërimet, transferime, pushime etj të kuadrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme.	01.06.1925 - 08.22.1925	200
I-811	Emërimet, transferime, pushime e sjellje të kuadrit të Ministrisë së Drejtësisë.	11.18.1923 - 10.18.1925	271

<b>Numri i dosjeve</b>	<b>Titulli</b>	<b>Viti (Filluar-Mbaruar)</b>	<b>Sasia e fletëve</b>
I-1929	Ligj mbi krijimin dhe organizimin e Këshillit Kontrollues.	04.07.1925	11
I-1930	Shkresë e Kryesisë së Dhomës së Deputetëve drejtuar Kryesisë së Këshillit të Ministrave, mbi pjesëmarrjen e ministrave në dhomën e deputetëve me rastin e diskutimit të projekt ose dekretligjeve.	11.03.1925	1
I-1931	Raport mbi marrëdhëniet politike të Shqipërisë me Fuqitë e Mëdha (shtetit) dhe shtetit fqinjë.	1925	2
I-1932	Shkresë e Ministrisë së Punëve të Brendshme drejtuar Kryesisë së Këshillit të Ministrave, mbi shqyrtimin e ankesës së një personi, kundër gjindarmëve që i kanë plaçkitur shtëpinë.	08.07.1925 - 08.26.1925	4
I-1933	Korrespondencë e Ministrisë së Punëve të Jashtme me Kryeministrinë, mbi emërimin e kuadrove të Ministrisë.	03.12.1925 - 09.12.1925	2
I-1934	Lutje e refugjatëve drejtuar Kryeministrisë në të cilën kërkojnë akordimin e një ndihme.	01.29.1925 - 10.24.1925	5
I-2067	Korrespondencë e Kryeministrisë me Kuvendin Kushtetues, Ministrinë e Financave Tiranë për zgjedhjen e deputetëve për senatorë.	03.03.1925 - 09.24.1925	12
I-2068	Korrespondencë e Kryeministrisë me Kryesinë e Kuvendit Kushtetues dhe Kryesinë e Dhomës së Deputetëve, mbi prezantimin e ministrave para Kuvendit Kushtetues dhe Dhomës së Deputetëve për të marrë votën e besimit të tyre.	02.07.1925 - 12.03.1925	7
I-2069	Telegram i Sekretarit të Përgjithshëm të Kryesisë së Republikës drejtuar klubit "Skënderbeg Athantio" USA, mbi amnistinë e nënshtetasve që nuk paraqesin rrezik.	03.12.1925	1
I-2070	Vendim i Këshillit të Ministrave mbi mbledhjen në Fllorencë të delegatit të Republikës tonë dhe atij të Mbretërisë Jugosllave për shqyrtimin e kartave të Kufirit Shqiptaro-Jugosllav, si dhe formimin e protokollit të fundit të kufirit të Shqipërisë së Sipërme.	01.03.1925	2
<b>II</b>	<b>Ushtria</b>		
II-136	Korrespondencë ndërmjet Kryeministrisë e Komandës së Përgjithshme të Gjindarmërisë, mbi organizimin e kompanive shëtitëse duke u ndërruar njëherë në 3-4 muaj.	06.05.1925 - 06.14.1925	2
II-137	Korrespondencë, mbi emërime, pushime, transferime, gradime etj të kuadrit ushtarak.	01.07.1925 - 10.20.1925	338
II-138	Projekt, mbi detyrat dhe kompetencat e Inspektorisë së Përgjithshme të Ushtrisë.	09.17.1925 - 11.14.1925	14
II-139	Korrespondencë midis Kryeministrisë, Komandës së Përgjithshme të Gjindarmërisë, mbi thyerjen e disiplinës nga oficerët duke u veshur me uniformën civile, hyrjen e tyre në lokale të papërshtatëshme, si dhe caktimi i oficerëve për ruajtjen e disiplinës.	04.29.1925 - 11.24.1925	13



<b>Numri i dosjeve</b>	<b>Titulli</b>	<b>Viti (Filluar-Mbaruar)</b>	<b>Sasia e fletëve</b>
II-140	Listë e oficerëve, që pandehen si shkaktarë të vëllavrasjes së fundit, si dhe një kopje raporti me shpjegime për disa oficerë.	10.25.1925 - 10.28.1925	13
II-141	Korrespondencë dhe njoftime, mbi sjelljet e veprimet e disa oficerëve të jashtë-ligjshëm, kërkohet marrja e masave kundër tyre.	03.02.1925 - 11.26.1925	18
II-142	Korrespondencë, mbi disa propozime e rregulla për degën e rekrutimit të ketë një kuadër të zot, stabil e tjera.	06.26.1925 - 08.06.1925	6
II-143	Korrespondencë, mbi sjelljet e graduantëve e gjindarmëve për kundërshtimet që ju ka bërë patrullave etj, kërkohet të merren masat e nevojshme.	04.11.1925 - 07.14.1925	6
II-144	Korrespondencë ndërmjet Kryeministrisë e Komandës së Përgjithshme të Gjindarmërisë, mbi zbatimin e ndjekjen e rrugës qerapike nga ana e oficerëve për çdo punë zyrtare që mund të kenë.	06.25.1925 - 07.15.1925	3
II-145	Shkresë e Kryeministrisë, drejtuar Komandës së Përgjithshme të Fuqisë Armate, mbi sjelljet brutale të oficerëve ndaj ushtarëve.	05.16.1925	1
II-146	Korrespondencë, me të cilën njoftohet se një oficer ka kaluar kufirin pa leje e autorizim, kërkohet marrja e masave kundër tij.	04.29.1925	5
II-147	Korrespondencë midis Kryeministrisë, Komandës së Përgjithshme të Fuqisë Armate e Komandës së Përgjithshme të Gjindarmërisë, mbi stërvitjen e mitralierëve të Gjindarmarisë.	06.06.1925 - 06.25.1925	11
II-148	Rregullore, mbi Bashkimin e Fuqisë Armate dhe Gjindarmërisë nën një titull (Komanda e Mbrojtjes Kombëtare).	02.13.1925	3
II-149	Njoftim, mbi dërgimin e shifrës së re.	07.01.1925	1
II-150	Korrespondencë midis Kryeministrisë, Komandës së Përgjithshme të Fuqisë Armate e Komandës së Përgjithshme të Gjindarmërisë, mbi vendosjen e rojeve ushtarake në kufirin e Dibrës e Himarës, për moskalimin e kondrbandëve e në vende të tjera.	02.07.1925 - 08.14.1925	11
II-151	Korrespondencë dhe njoftime, mbi mospakësimin e fuqive operative për nevoja të operacionit, përbërja numerike e tyre, si dhe shpërndarja e një pjese të fuqive operative etj.	04.15.1925 - 12.13.1925	36
II-152	Korrespondencë dhe njoftime, mbi operacionin në zonën e veriut, përfundimi i tij në disa krahina, shihet e nevojshme qëndrimi i disa kompanive, kërkohet fuqi pasi populli i Kthellës nuk bindet dhe është i armatosur, kërkohet që pasi operacioni të marrë fund në Malësinë e Madhe të kalojë në çarmatimin e fuqisë zyrtare në Shkodër etj.	01.10.1925 - 11.16.1925	25

<b>Numri i dosjeve</b>	<b>Titulli</b>	<b>Viti (Filluar-Mbaruar)</b>	<b>Sasia e fletëve</b>
II-153	Korrespondencë e Kryeministrisë me Komandën e Përgjithshme të Gjindarmërisë, mbi dërgimin e një kompanie gjindarmësh në zonën e veriut, për t'iu bërë ballë ngjarjeve që ndodhin etj.	08.06.1925	3
II-154	Njoftime të Ministrisë së Punëve të Brendshme, mbi operacionin në Mirditë e në Shkodër për mbledhjen e armëve, ndihma që duhet të dërgohet e marrja e masave të tjera për një përfundim të mirë të operacionit.	05.17.1925 - 09.21.1925	5
II-155	Korrespondencë ndërmjet Kryeministrisë e Komandës së Përgjithshme të Fuqisë Armate, mbi fillimin e operacionit në jug për ndjekjen dhe shtirjen në dorë të të arratisurit të rrezikshëm për sigurimin e qetësisë, si dhe fuqia e konsiderueshme që do të jepet për këtë operacion.	04.09.1925	2
II-156	Korrespondencë, mbi ndihmën që duhet të japin fuqitë operative prefekturave në rast nevojë, prandaj urdhërohen që sa herë që do të shihet e nevojshme atyre u jepet ndihma e fuqia e nevojshme.	07.30.1925 - 09.07.1925	5
II-157	Shkresë e Komandës së Përgjithshme të Fuqisë Armate, me të cilën kërkohet të shpallet shtetrrëthimi në viset e veriut dhe krijimi i Gjyqit Ushtarak të shtetrrëthimit.	09.11.1925	1
II-158	Korrespondencë, mbi orarin e takimit midis Komandantit të Përgjithshëm të Gjindarmërisë dhe Inspektorit të Përgjithshëm, si dhe njoftimet e ngjarjeve të çdo dite t' i jepen inspektorit etj, për mosshkaktuar mosmarrëveshje.	06.30.1925 - 08.02.1925	6
II-159	Korrespondencë ndërmjet Kryeministrisë e Komandës së Përgjithshme të Fuqisë Armate, mbi vënien në dijeni Kryetarit e Shtet Madhërisë për gjithë veprimet e aktet, që nxjerr agjindatura e asaj Komande duke pasur dhe nënshkrimin e tij.	06.04.1925 - 06.12.1925	3
II-160	Korrespondencë midis Kryeministrisë, Komandës së Përgjithshme të Fuqisë Armate e Komandës së Gjindarmërisë, mbi ndërhyrjet që i bëhen Gjindarmërisë nga detashmentët e vullnetarët.	07.15.1925 - 09.15.1925	5
II-162	Dekret, parashtresa, korrespondencë etj, mbi thirrjen nën armë për kryerjen e shërbimit ushtarak, organizimi i ushtrisë, shpërndarje e riparim kompanish, zgjatja e shërbimit ushtarak etj, si dhe thirrjen në shërbim të punëtorisë ushtarake për 3 muaj si këpucarë, rrobaqepës etj.	01.10.1925 - 12.21.1925	118
II-163	Korrespondencë, mbi disa çështje të rekrutimit për Gjindarmërinë, të mos çregjistrohen gjindarmët, që nuk kanë mbushur shërbimin dhe të mosmerret asnjë pa plotësuar shërbimin aktiv të ushtrisë.	04.27.1925 - 09.23.1925	14

Numri i dosjeve	Titulli	Viti (Filluar-Mbaruar)	Sasia e fletëve
II-164	Vendim i Këshillit të Ministrave e korrespondenca përkatëse, mbi rekrutët që nuk kanë plotësuar shërbimin ushtarak e do të thërriten nën armë, në rast se iu del nevoja për të dalë jashtë shtetit si çështje sëmundje etj, duhet të lenë një garanci prej 2000 fr. ari pranë rekrutimit dhe të kthehen në kohën që do t'ju caktohet.	01.13.1925 - 08.10.1925	14
II-165	Korrespondencë, mbi disa padrejtësi e abuzime që bëhen nga prefektët e nënprefektët si kryetarë komisionesh, gjatë kontrollimit të rekrutëve.	09.17.1925 - 09.23.1925	4
II-166	Korrespondencë, mbi përjashtimin e nënshtetësve të huaj nga shërbimi ushtarak.	03.07.1925 - 04.01.1925	5
II-167	Forma e betimit ushtarak.	03.21.1925 - 03.24.1925	3
II-168	Korrespondencë dhe ankesa, mbi armët që u janë marrë me rastin e çarmatimit dhe kërkojnë t'ju lejohet e t'u jepen armët pasi nuk iu sigurohet jeta dhe pasuria e tyre nga armiqtë etj.	03.08.1925 - 11.16.1925	17
II-169	Shkresë e Kryeministrit, me të cilën porositet Komanda e Përgjithshme e Gjindarmërisë që armët e mbledhura në jug t'i dorëzohen Komandës së Përgjithshme të Fuqisë Armate.	08.27.1925	1
II-170	Vendime të Këshillit të Ministrave, korrespondencë etj, mbi porosinë e lidhjen e kontratave me firma në shtete të ndryshme e akordim shuma për blerje, armatim e veshmbathje për ushtrinë, si dhe shpërndarja dhe nevojat e ndryshme që paraqiten brenda për municione etj.	02.21.1925 - 12.14.1925	106
II-171	Rregullore e uniformës së ushtrisë e Gjindarmërisë Shqipëare, mbi uniformën e paradave e të salloneve.	02.23.1925 - 01.10.1926	34
II-172	Korrespondencë midis Kryeministrit e Komandës së Përgjithshme të Fuqisë Armate, mbi lirimimin e kazermës që nevojitet për nevoja të ushtrisë.	04.01.1925 - 08.08.1925	4
II-173	Vendim i Këshillit të Ministrave e korrespondencë, mbi shitjen e materialeve të artilerisë si gjyle etj, por kjo shitje të mos bëhet pa kontrollin e Komandës Armate. (vendimit i mungojnë fletët).	04.29.1925 - 09.08.1925	3
II-174	Korrespondencë ndërmjet Kryeministrit e Komandës së Përgjithshme të Fuqisë Armate, mbi marrjen e shënimeve në ofertat e paraqitura nga Kantiera "Navola" e Trieshtit, për nevojat që mund të kenë për hidroplane.	12.22.1925 - 12.28.1925	2
II-175	Korrespondenca, mbi sigurimin e ushqimit të ushtrisë, si dhe ushqimi i oficerëve gjatë kohës që bëjnë manovra.	08.12.1925 - 12.18.1925	7
II-176	Korrespondencë midis Kryeministrit e Komandës së Gjindarmërisë, mbi kthimin e disa kafshëve Komandës së Gjindarmërisë, që i janë marrë nga Komanda e Përgjithshme e Fuqisë Armate.	09.24.1925 - 10.12.1925	4

<b>Numri i dosjeve</b>	<b>Titulli</b>	<b>Viti (Filluar-Mbaruar)</b>	<b>Sasia e fletëve</b>
II-177	Vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, korrespondencë etj, mbi hapjen e një shkolle për përgatitjen e oficerëve të rinj, hapja e një kursi, plotësimi i kuadrit, si dhe fondet përkatëse etj, që nevojiten për këtë shkollë.	02.18.1925 - 11.04.1925	26
II-178	Shkresë e Kryeministrisë, mbi një inspektim që është bërë në Shkollën e Nënoficerëve të Gjindarmërisë, gjendja e keqe e mungesat e shumta që janë konstatuar.	10.15.1925	1
II-179	Korrespondencë midis Kryeministrisë e Komandës së Përgjithshme të Fuqisë Armate, mbi afatin e studimeve për studentët që vazhdojnë shkollat ushtarake në Francë, kërkesa për t'u dërguar në këtë shkollë, si dhe mbi largimin e një studenti e kthimin e tij në Shqipëri për sjellje jo të mira.	07.10.1925 - 10.11.1925	10
II-180	Korrespondencë ndërmjet Kryeministrisë e Komandës së Përgjithshme të Fuqisë Armate, mbi zgjatjen e kontratës të detashmentit rus që është marrë në shërbim të Shtetit Shqiptar për stërvitjen e artilerisë shqiptare.	02.26.1925 - 10.26.1925	8
II-181	Vendime të Këshillit të Ministrave, kontrata etj, mbi marrjen në shërbim të shtetit shqiptar disa oficerë anglezë si organizatorë të Gjindarmërisë, si dhe sjelljet dhe ndërhyrjet e tyre në çështje që nuk i takojnë.	04.1925 - 12.29.1925	40
II-182	Vendim i Këshillit të Ministrave e korrespondenca përkatëse me Komandën e Përgjithshme të Fuqisë Armate, mbi sjelljen nga jashtë teknikën specialiste për administrimin e përdorimin e armëve e municionit.	06.06.1925 - 10.12.1925	3
II-475	Korrespondencë e Kryeministrisë me Komandën e Fuqive Armate, mbi paraqitjen e projektit për formimin e nëntë (9), drejtorive të rekrutimit në qendra të ndryshme si prej organizimit të ushtrisë.	03.03.1925 - 08.06.1925	3
II-476	Rregullore e bashkëpunimit ndërmjet gjindarmërisë dhe administratës civile.	10.29.1925	4
II-477	Korrespondencë e Kryeministrisë me Komandën e Fuqive Armate mbi furnizimin dhe pajisjen e ushtrisë.	01.10.1925 - 12.16.1925	13
<b>III</b>	<b>Ekonomi-Financë</b>		
III-480	Korrespondencë e Kryeministrisë me Ministrinë e Punëve Botore e Ministrinë e Bujqësisë mbi kanalizimin e lumenjve të Drinit, Bunës dhe të Kirit.	06.09.1923 - 07.14.1925	34
III-506	Ligj, lutje e klubit tregtar të Korçës, si dhe korrespondenca përkatëse mbi ngritjen e moratoriumit të Korçës për mbarëvajtjen e tregtisë në atë qytet.	01.17.1923 - 07.14.1925	63

<b>Numri i dosjeve</b>	<b>Titulli</b>	<b>Viti (Filluar-Mbaruar)</b>	<b>Sasia e fletëve</b>
III-573	Vendime etj. si dhe korrespondenca të Kryeministrit me Ministrinë e Financave mbi pagim rrogash të prapambetura.	03.24.1922 - 07.09.1925	126
III-602	Lutje të personave të ndryshëm, si dhe korrespondencë e Kryeministrit me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Ministrinë e Drejtësisë mbi çështje tokash.	06.13.1923 - 09.26.1925	19
III-710	Vendime të Këshillit të Ministrave etj. mbi hapje, ndryshime dhe mbartje fondesh financiare.	01.18.1924 - 01.17.1925	466
III-731	Vendime të Këshillit të Ministrave etj. mbi të drejtën e pronësisë së trashëguar.	04.30.1924 - 01.25.1925	23
III-735	Telegram i Mihal Gramenos drejtuar Ahmet Zogut mbi popullin e mjerë që dergjej nëpër rrugë për bukën e gojës, që vjen nga moskujdesia e hajdutëritë e autoriteteve tuaja.	09.12.1925	1
III-736	Kërkesë e popullit të krahinave Kurvelesh, Krujë dhe Mirditë mbi vuajtjet e popullit të këtyre krahinave nga mungesa e shërbimit shëndetësor, arsimit, komunikacionit etj.	07.18.1925 - 11.23.1925	9
III-737	Kërkesa dhe korrespondencë mbi papunësinë në Shqipëri, largimi i nënshtetasve jashtë atdheut për të siguruar punë, si dhe kërkesa e popullit të Gramshit që detyrohen të punojnë larg qendrës së tyre, etj.	03.22.1925 - 12.21.1925	20
III-738	Dekretligj mbi ndalimin e hyrjes të çdo punëtori në Shqipëri për arsye të krizës e papunësisë për vetë punëtorët shqiptarë.	02.23.1925 - 03.14.1925	3
III-739	Vendime, kërkesa e korrespondencë mbi shtrenjtësinë e madhe në Shqipëri në ushqim dhe banim, mungesën e bukës, si dhe për ulje dhe heqje të taksës doganore të miellit dhe të kripës që përdoret për prodhimin e sapunit.	03.03.1925 - 10.31.1925	14
III-742	Raport, korrespondencë etj. mbi konvencionin e lidhur ndërmjet Ministrisë së Punëve Botore e Bujqësisë e dy personave për fabrikimin e alkoolit.	10.17.1925 - 11.17.1925	13
III-743	Dekrete, vendime, konventa, etj. dokumente lidhur ndërmjet Qeverisë Shqiptare e shoqërive të huaja të Italisë, Anglo - Persiane, etj. mbi koncesionet e shfrytëzimit të vajgurit e hidrokarbureve në Shqipëri.	01.20.1925 - 07.27.1925	400
III-744	Vendim, konventa, raporte e korrespondenca përkatëse mbi koncesionin e qymurgurit në Memaliaj.	02.21.1925 - 10.26.1925	45
III-746	Vendime, marrëveshje, kontratë e korrespondenca përkatëse mbi dhënie në koncesion shfrytëzimin e mineraleve të Pukës për madem, bakër e të tjera minerale, përfaqësuesit të Bankës Serbo - Shqiptare, Nikolla Zuber.	11.05.1925 - 11.21.1925	36

Numri i dosjeve	Titulli	Viti (Filluar-Mbaruar)	Sasia e fletëve
III-749	Vendime, dekrete, kontrata, etj. mbi dhënien në koncesion shfrytëzimin e pyjeve të Shqipërisë së Veriut, kontraktimet për shitjen e lëndës pyjore në krahinat e Libohovës, Lushnjës e Beratit, si dhe anulimin e këtij koncesioni për mospërbushje të detyrimeve.	02.06.1925 - 11.05.1925	35
III-751	Vendim i Këshillit të Ministrave e korrespondencë mbi prishjen e kontratës lidhur ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë e Konidha Frashërit për koncesionin e dhënë të përdorimit të banjave të " Urës së Kadiut " në Përmet.	03.28.1925 - 04.09.1925	2
III-752	Dekretligj, vendim e korrespondenca përkatëse mbi pagimin e rregullimin e llogarive, heqjen e taksës doganore të materialeve që importon shoqëria franceze koncesionare për punime e ndërtime urash në Shqipëri.	01.28.1925 - 12.22.1925	33
III-753	Vendime të Këshillit të Ministrave, notë verbale dhe korrespondenca përkatëse mbi një marrëveshje ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Jugosllavisë për rregullimin e Drinit dhe të liqenit të Shkodrës.	03.03.0925 - 12.05.1925	5
III-754	Dekretligje, vendime, protokoll, traktate etj. mbi nënshkrimin e Traktatit të Tregtisë dhe të Lundrimit e marrëveshje konsullore ndërmjet Shtetit Shqiptar dhe Italisë.	01.20.1925 - 12.17.1925	107
III-755	Vendim i Këshillit të Ministrave, korrespondencë etj. mbi aprovimin e statusit të shoqërisë anonime " Shoqëria Gjenerale e Elektrikut " me qendër në Korçë e dhënien në koncesion të elektrikut të Korçës.	07.09.1925 - 10.01.1925	35
III-756	Vendim dhe korrespondencë mbi dhënien në koncesion një shoqërie në Paris të ndriçimit të bregdetit të Shqipërisë.	08.24.1925 - 09.05.1925	3
III-758	Vendime të Këshillit të Ministrave dhe korrespondenca përkatëse mbi marrjen në shërbim specialistë të huaj.	12.02.1924 - 11.02.1925	47
III-759	Korrespondencë ndërmjet Kryeministrisë e Ministrisë së Punëve Botore e Bujqësisë mbi formimin e Këshillit të Ministrave për zgjidhjen e veprimeve minerale.	06.10.1925 - 12.30.1925	3
III-760	Korrespondencë ndërmjet Kryeministrisë e Ministrisë së Punëve Botore e Bujqësisë mbi një raport që është gjetur në postë, në të cilin flitej për pasuritë e nëntokës në Shqipëri, si dhe të bëhen hetime dhe masat kundër personit që ka nxjerrë raportin në fjalë.	07.18.1925 - 07.28.1925	4
III-761	Korrespondencë mbi dhënie leje Et`hem Tolës për ngritjen e një fabrike për prodhimin e tullave e tjegullave të ndryshme.	07.10.1925 - 07.29.1925	5

<b>Numri i dosjeve</b>	<b>Titulli</b>	<b>Viti (Filluar-Mbaruar)</b>	<b>Sasia e fletëve</b>
III-762	Vendim i Këshillit të Ministrave, korrespondencë etj., emërime përfaqësuesi pranë shoqërive të vajgurit, si dhe emërime, pushime, transferime të kuadrit të Ministrisë së Punëve Botore e Bujqësisë.	01.21.1925 - 12.29.1925	78
III-763	Korrespondencë ndërmjet Kryeministrisë e Ministrisë së Punëve të Brendshme mbi iniciativën e Prefekturës së Shkodrës për të bërë kanalizimin e Trushit, ku flitet dhe për gadishmërinë e popullsisë në këtë zonë.	06.11.1925 - 06.18.1925	2
III-765	Ankesë e një personi për blerjen e një are e një luadhi, si dhe mohimet e pengimet që i janë sjellë nga nëpunësit e kadastës për lëshimin e tapive, kërkon marrje masash për mosmbrojtjen e këtyre lloj nëpunësish nga zyra kadastrale.	10.05.1925	4
III-766	Ankesa të disa personave në katundet e Korçës, ankohen kundër popullit të katundit Bozhigrad për prerjen e drurëve e filizat në korijet e tyre duke përdorur edhe forcën e armëve, etj.	01.06.1925 - 01.08.1925	4
III-767	Ligj dhe korrespondencë mbi zhvillimin e përmirësimin e kryeqytetit, etj.	07.06.1925 - 12.17.1925	6
III-768	Dekretligj mbi punimet në rrugë.	12.22.1925 - 12.31.1925	8
III-769	Vendime të Këshillit të Ministrave, raport etj. mbi caktimin e çmimit të truallit për ngritjen e godinave të Bankës Kombëtare në Tiranë e në Durrës.	06.09.1925 - 07.28.1925	12
III-770	Vendim i Këshillit të Ministrave dhe korrespondencë mbi vënien në adjudikatë të sipërmarrjes të ndonjë rruge ose ure, mënyrat e veprimit për këto raste.	08.23.1925 - 09.05.1925	2
III-771	Vendim i Këshillit të Ministrave e korrespondencë mbi anulimin e vendimit për mosndreqjen e shtëpive në kryeqytet me qerpiç.	10.26.1925 - 11.02.1925	2
III-772	Korrespondencë mbi plogështinë e indiferentizmin e kryerjes në kohë të punimeve në rrugë, si dhe ankesa të popullit mbi detyrimet e jashtëligjshme që ju bëhen, etj. për nxjerrjen e tyre në burime rrugësh.	06.14.1925 - 11.05.1925	21
III-773	Kërkesë në emër të popullit të Elbasanit e korrespondencë mbi ndërtimin e urave në këtë rreth mbasi ndodhen në gjendje të mjerueshme, si dhe kërkesa për ndreqje rrugësh në krahinat e Ishmit e të Fierit.	02.25.1925 - 09.28.1925	27
III-774	Kërkesa të banorëve të Lushnjës lidhur me planin rregullues të qytetit të Lushnjës, kërkojnë që ky plan mos të vihet në zbatim mbasi është i padrejtë.	01.15.1925 - 12.16.1925	20
III-775	Ankesa mbi ndërtimin e rrugës që bëhet në mes të livadheve, oborreve të tyre, kërkojnë ndryshimin e kësaj rruge.	10.24.1925 - 10.28.1925	5
III-777	Parashtresa dhe telegrame mbi ngritjen e godinave qeveritare, ndërtimi i një rruge etj.	04.18.1925	7

<b>Numri i dosjeve</b>	<b>Titulli</b>	<b>Viti (Filluar-Mbaruar)</b>	<b>Sasia e fletëve</b>
III-778	Telegram ankimi i një tregtari e korrespondenca mbi mbylljen e dyqanit duke mos i lejuar shitjen e mallit.	03.23.1925	5
III-779	Ligj, dekretligj, projekt, korrespondencë, etj. mbi ndalimin e tranzitit në tokë.	05.29.1925 - 09.17.1925	11
III-780	Kërkesë e pleqërive të Durrësit mbi lënien të lirë për importin e miellit të bardhë nga Europa.	02.07.1925	1
III-781	Vendime, korrespondencë mbi mungesën e kripës në Prefekturën e Kosovës, si dhe ndalimi i importit të kripës nga Jugosllavia.	02.28.1925 - 12.27.1925	19
III-786	Projektligj, rregullore e korrespondenca mbi shërbimin e automobilave dhe e çdo qerre me fuqi motorike dhe patentimin e shoferave.	10.07.1924 - 08.22.1925	38
III-788	Njoftime të prefekturave në të cilët njoftohen emrat e pasagjerëve që udhëtojnë për jashtë si dhe ata që dalin në portet përkatëse.	05.25.1925 - 12.12.1925	51
III-789	Ligj dhe projektligj mbi administratën e telegrafave dhe telefonave, si dhe mbi pranimin e telegrameve.	03.30.1925 - 11.21.1925	24
III-790	Raporte, justifikuese, skemë e korrespondenca përkatëse mbi ndërtimin vijave telefonike me dubël fill.	01.25.1925	6
III-791	Vendim i Këshillit të Ministrave e korrespondencë mbi vënien në zbatim shërbimin e mandatpostës së brendshme.	02.07.1925 - 02.18.1925	3
III-792	Dekretligj e vendime të Këshillit të Ministrave mbi krijimin e pullave postare, një pullë për Kryqin e Kuq etj.	01.26.1925 - 12.23.1925	17
III-793	Shkresë e Ministrisë së Punëve të Jashtme mbi një konferencë ndërkombëtare që do të bëhet në Francë mbi qarkullimin e automobilave, këkohet që të marrë pjesë dhe vendi ynë.	12.12.1925	1
